

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

AGIM BAÇI

KARUSELI SOCIOLOGJIK I PERSONAZHEVE TE VEPRA E ISMAIL KADARESE

Teza që po parashtrojmë sot në mënyrë të shkurtuar synon të japë një pasqyrë të elementeve ndërlidhëse të strukturës/infrastrukturës qytetëimore të botës kadareane me lëndën njerëzore të botës së tij rrëfimore. Edhe pse ka studime që i ndërlidhin këta dy përbërës të qenësishëm, në rastin e Kadarese duket se ka shumë për të thënë në planin e sociologjisë së personazheve. Pjesë përbërëse thelbësore të këtij universi kadarean janë dy:

1. Strukturat e infrastrukturat qytetëimore (me një tipologji shumë të pasur të tyre)
2. Lënda njerëzore - personazhet.

Vetë autori e ka konfirmuar në shkrime të tij diskursive këtë përfundim të lidhjes mes personazheve dhe qyteteve, duke bërë me dije se ky koncept ka qenë plotësisht i vetëdijshëm, në qendër madje të poetikës së tij krijuese.

Gjithashtu, është synuar edhe raporti Kadare-personazh, si dhe Kadare-Sistemi. Ky raport është shumë i lidhur edhe me lëndën njerëzore dhe infrastrukturën qytetëimore në të cilat ndërtohen ngjarjet në veprat e Kadarese.

Tema synon të qartësojë në mënyrë analitike fytyrën e veçantë të personazheve, kategoritë e tyre, ndërvlerësitë e marrëdhëniet mes tyre, si dhe të ndriçojë përmes gjithë kësaj sociologjinë dhe antropologjinë komplekse të universit njerëzor-qytetëimor kadarean, një univers me identitet shumë të spikatur ky në hartën e letërsisë së përbotshme.

“Sa herë lexojmë diçka, vëmendja jonë përqendrohet njëkohësisht në dy drejtime. Njëri drejtim është i jashtëm dhe centrifugal, në të cilin ne vazhdojmë të dalim jashtë leximit, nga fjalët e veçanta në gjërat që nënkuptojnë ato, ose, praktikisht, në kujtesën tonë të asosacioneve konvencionale ndërmjet tyre. Drejtimi tjetër është centripetal, në të cilin ne përpiqemi të sajojmë nga fjalët një kuptim të modelit më të gjerë verbal që bëjnë ato. Në të dy rastet kemi të bëjmë me simbolet”¹.

Leximet për prozën kadareane, qofshin në diktaturë, qofshin në pasdiktaturë, kanë pasur drejtim të jashtëm dhe centrifugal, për shkak të asaj çfarë kanë shkaktuar nënkuptimet, konvencionet apo asosacionet e ndryshme. Ky lexim i lidhur me raportet sociologjike, nuk lidhet shumë me stilistikën, e cila duhet parë jashtë realiteteve të njohura dhe sugjeruara nga autori, apo nga historia e përbashkët me të. Këndvështrimi i një karuseli sociologjik lidhet me lëvizjet jo

¹ N. Fraj, *Anatomia e kritikës*, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 104.

vetëm gjeografike, por edhe të kuptueshmërisë, të psikologjisë që bartnin emrat, fabulat që lëviznin në qytete të ndryshme, vende të ndryshme, kohë të ndryshme.

Studiuesi Robert Elsie thekson se, “*veprat e Kadaresë gjithmonë kanë qenë pasqyrim i përpiktë i peripecive të jetës politike shqiptare.*”², duke hapur pikërisht këtu detin e pohimeve apo mohimeve të mëdha që kanë përfshirë këtë këndvështrim mbi prozën kadareane.

Megjithatë, mund të thuhet pa frikë se stili i mbështetur në asosacione kundërshtuese “as ashtu- as kështu” dhe “edhe ashtu-edhe kështu” përbëjnë një “tunel stilistik” të ndërftues së lexuesit në bashkudhëtim me autorin. Ajo që ka ndryshuar në këtë tunel, është se në diktaturë lexuesi ishte më shumë në errësirë, ndërsa në pasdiktaturë është në krahun e dritës. Duke “parë më shumë vetë” lexuesi i pas vitit 1990 e gjykon letërsinë me lirinë e tij të fituar. Pikërisht ky ndryshim leximesh është edhe pritshmëria, apo “horizonti i pritjes” që na thotë Jauss.

Ndarja e punimit tonë në këndvështrimin e një karuseli sociologjik, që synon ndryshimet ligjërimore, na jep mundësinë të futemi në një zbërthim përmes gjuhës së brendshme për qëndrime antiregjim, proregjim, antilindje, properëndim, nostalgjike, ëndërrimtare, normale.

Si dallohet kjo sociologji gjuhësore tek qytetet?

1- Gjirokastra, ose oazi i lojërave femërore dhe nostalgjisë

Aty ku nisin të gjitha imagjinatat, personazhet mes përrallave dhe realitetit, ku nis imagjinata dhe ku rikthimi mbetet gjithnjë një rrugëtim i dashur, duke përfshirë gjithçka, por përherë me magjinë e ëndërrimit, ku bota mbetet e pafund, por edhe rrokulliset nëpër tjegullat e shtëpive që nuk ndahen. Proza që ka të bëjë me qytetin i ngjan rritjes së një njeriu. Kadare shprehet në librin *Ftesë në studio* se ideja për të shkruar për qytetin e tij i lindi në Moskë, kur ishte student. Përshkrimi i bërë nga ai përballë shokëve, si dhe konfirmimi nga kolegu i tij grek për Gjirokastrën, duket se shënjuan brenda tij qytetin që duhet t’u jepte të gjithëve. Ardhur fillimisht përmes rrëfjave *Qyteti i jugut*,³ përmes 18 skicash, Gjirokastra do të vijë e të bëhet kryeqendra e përshkrimit në librin “Qyteti pa reklama” e më pas në “Kronikë në gur”.

Të dy veprat janë vazhdim apo dublim i njëra-tjetrës. Mbizotëron dëshira për të gjetur një zgjidhje për të dalë nga anonimati. Një kredo e autorit e paralajmëruar se nuk do të mbetet anonim, se do të zbulojë “shkrimin e shenjtë” që në fakt është letërsia. Qyteti me personazhe që duket se i kanë mbetur autorit në fëmijëri, me emra të çuditshëm si sokaqet, dhe në sfond një histori prostitutash, në shtëpinë publike, që shpjegon fantazinë për seksin.

Çështje të marrëzisë ishte epilog i sagës familjare, që nis me *Kronikën në gur*, vazhdon me *Brezin e Hankonatëve* dhe tri novelat më pak të njohura: *Koha e shkrimeve*, *Koha e parasë* dhe *Koha e Dashurisë*, Darka e Gabuar, ku kadarenjtë përmenden në mënyrën më të habitshme, ndonëse u shkrua më pas pjesëve me

² R. Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2001, f. 388.

³ *Revista Nëntori*, shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1964.

këtë cikël.⁴ Te *Kronika*, Kadare jeton në një botë ku përballë ka “plaka që nuk çuditen nga asgjë dhe që nuk kanë frikë”, të cilat qyteti i njeh dy llojesh: Plakët katënxha dhe plakët e jetës⁵ “Nisja e Kako Pinos për një dasmë donte të thoshte se qyteti mund të jetonte dhe pa pushtet. Megjithatë, koha ishte e pasigurt, si çdo kohë kalimtare. Rendi i jetës ishte prishur. Gjyqi s’punonte. Gazeta nuk dilte. Nuk kishte më as shpallje të bashkisë, as afishe, as urdhëresa. Lajmet e ndryshme, të brendshme ose të jashtme, kalonin gojë më gojë. Burimi i tyre kryesor ishte një plakë e panjohur gjer tani, emri i së cilës u përhap papritur në këto ditë pa fytyrë. E quanin Sose, por shumica e thërrisnin plaka Habere”⁶.

Moska, situatë e së pamundshmes

Diku larg, gjithnjë një botë gati e pamundshme, plot rebuse mes fuqisë së panjohur dhe të njohur, gati e paarritshme. Atje ku edhe dashuria tentohet por nuk arrihet, ku gjërat mbesin më shumë larg sesa afër dhe ku na duhet të dorëzohemi ndaj së pamundshmes. “Shpesh qëllonte që në objektivin e aparatit futej ndonjë çift që shëtiste tutje në breg dhe që, kur e lanim filmin, dilte si ndonjë njollë e vogël, e humbur dhe pa asnjë rëndësi në gjithë atë hapësirë”⁷.

Edhe kur rikthehet përmes *Dimrit të Vetmisë së Madhe* Moska mbetet sërish atje, në zonën e hijes pa dritë. Këtë herë politikisht. Përshkrimi i rrugëve të Moskës duket krejt pa gjallëri, ndërkohë që jepet vetëm atmosfera rreth Sheshit të Kuq, pranë Muzeleumit të Leninit. E megjithatë, gjithçka është e largët, si një mjegull, si diçka e pakapshme, mesjetare. “Besnikut iu kujtua nata e parë në vilë, klithma e telefonit-kukuvajkë. Bujtës në kështjellë, tha me vete. Në kështjellën mesjetare, plot hije e tmerr, shtoi pas pak dhe mbështeti ballin te qelqi i mbuluar me ngricë”⁸.

Të dy romanet përshkojnë momentin e prishjes së marrëdhënieve me Sovjetikët. Te “Dimri i vetmisë së madhe” paralajmërohet ndryshimi i jetës së studentëve, teksa porositen që t’u qëndrojnë larg femrave. Te “Muzgu i perëndive të stepës” ky apel i ardhur nga “Dimri..” aplikohet, teksa student duhet t’i largohet biondinës Lida Snjeginën, të imitojë të vdekurin, ashtu siç ishte shprehur për legjendën e Kostandinit me Doruntinën.

Tirana, shtëpia e (a)normales

Këtu gërshetohen të gjitha gjërat brenda së mundshmes, ku mendohet dhe veprohet “me logjikë”, ku beteja është e arritshme, ku armiku dhe miku kanë shtëpinë përballë, ku pritet sukcesi dhe ndëshkimi. Më e theksuar se kudo Tirana vjen me atë që konsiderohet si “diptiku i Tiranës”, përmes “Dimrit të vetmisë së madhe” dhe “Koncert në fund të stinës”. Më pas plotësohen me romanin “Hija”, i cili vjen edhe si një dallim i qartë i ndryshimit mes jetës në Tiranë dhe jetës në

⁴ H. Kadare, *Kohë e pamjaftueshme*, Onufri 2011, f. 115.

⁵ Po aty, f. 132.

⁶ Po aty, f. 199.

⁷ I. Kadare, *Muzgu i perëndive të stepës*, pjesë e triptikut *Ura me tri harqe*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1978, f. 356.

⁸ Po aty, f. 226.

Paris përmes gjithë pikëpyetjeve të Kineastit. Personazhet janë sërish thuajse po ata, ku Besnik Struga, Skënder Bermema, Zana, Silva, Ana Krasniqi, Gjergji, si dhe bodrumi i Nurihasë tregojnë të thënat dhe të pathënat e Tiranës. Diskutimet në kafe, kënga e pastruesit në orët e vona, jeta letrare e dhënë përmes “kritikut Zija Shkurti” që është një poet i dështuar, janë pjesa piktoreske, që plotësohet pastaj me jetën në bllok, e përballë tyre, shpresa e “miqve të Nurihasë” që gjithçka të rrëzohet.

Nëse do t’i referoheshim Nathrop Fraj, në librin e tij *Anatomia e kritikës* ku shprehet se, “*Letërsia është një degëzim qendror i humaniteteve, hedhur nga njëra anë nga historia dhe nga ana tjetër nga filozofia*”, atëherë do të pohojmë se dy romanet “diptik” janë një “iliadë e viteve të përplasjeve me Moskën dhe Pekinin, ku shprehen me nota realiste ngjarjet mes Tiranës dhe dy vendeve që vendosnin shumë për jetën në Shqipëri e nga ku vareshin fate të ndryshme, ëndrra të ndryshme, të njerëzve që kishin të bënin ose as nuk kishin kurrfarë dijenie për një botë atje larg, përtej.

Besniku, Skënderi, Suzana, Silva, Gjergji, janë përfaqësues të një gjenerate, e cila jetoi në një kohë ku u vulosën disa prej ndryshimeve më dramatike, ku realja dhe qesharakja nuk kishin shumë kufij të qartë.

2- **Parisi, aty ku mungojnë kufijtë**

Është qyteti që pranon gjithçka, ku më normal bëhet bohem, ku “i lejohe vetes gjithçka” dhe ku njeriu mundet të dëfrehet e të mendojë ndryshe. Është kryeqyteti i kulturës, i lirisë dhe ku njeriut i hapen befasisht rrugët, por pa mundur t’i kthejnë një përgjigje, nëse kjo liri është në të mirë të tij. Kineasti, njeri serioz në Tiranë, jeton në Paris ëndrrën e tij për të menduar për gjithçka. Nuk mungojnë përshkrimet, seksi, të cilat vijnë me natyrshmërinë e qytetit ku “liria e shtyp moralin”. Kineasti nuk është veçse një alterego e vetë Kadaresë, që shpesh pas kthimeve nga Parisi duhej të heshte me shokët e tij në Tiranë, ose të përballej me hamendjet e tij për jetën atje. Shoku nga Moska bën bashkimin e rinisë me moshën kur vizitonte Parisin, duke bashkuar dy kohë, kur Gjirokastra dhe Tirana ishin imagjinatë dhe koha larg tyre kthehej në realitet. “*Një herë m’u duk se ishte truri i shokut tim të Moskës, që e rrezatonte gjithë këtë turbullirë. Më erdhi të ngrihesha e ta kapja për fyti atë që kishte qenë për aq vite njeriu im më i afërt. Më thuaj, kush është njeriu dhe kush është hija e vet? Natyrisht, ti e mban veten për pjesën hyjnore të qenies sonë dyshe...*”⁹

Stambolli, bota që nuk ecën përpara

Nga andej vijnë ata që “u ka mbetur ora”, më kokën pas, të paafte për të kapur trenin e qytetërimit, dallkaukët. E lidhur ngushtësisht me drejtuesit-harem, ku mendja e atij që vjen dhe dëshira e atij që është nuk puthen. *Pashallëqet e mëdha, Komisioni i festës, Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave, Kamarja e turpit* sjellin pjesë nga ajo atmosferë e otomanëve, duke i lënë mes të mundshmes dhe pamundshmes, ku më shumë gjërat janë imagjinatë sesa realitet. E vetmja gjë

⁹ I. Kadare, “Hija”.

reale, në mënyrë krejt paradoksale, janë ëndrrat që duhen shpjeguar nga Mark Alemi te *Nëpunësi i pallatit të ëndrrave*.

Edhe *Kështjella*, *Rrethimi* dhe *Ura me tri harqe* sjellin paralajmërim e një ndryshimi social që do të ndodhë pas “moralit që vjen nga “Stambolli”. “*Grave dhe vajzave të tyre do t’u heqim veshjet e bardha e të paturpshme dhe do t’u veshim rrobën e zezë dhe fisnike, të bekuar nga feja. Ne do të mbulojmë me perçe të zezë fytyrat dhe sytë e tyre dinakë, me të cilat ato, gjer tani, shikohen lirisht me meshkujt*”¹⁰.

Për atë që vjen nga Stambolli gratë e Haremit vendosin vetëm një destinacion, që vjen në një stilistikë të papërsëritshme, teksa krijohen dy botë vetëm nga ndryshimi Abdulla-Abdullath. Prapashtesa në shqipe me “Th”, që jep vizion ledhatues, jep destinacionin e zyrtarit që vjen nga Stambolli: Seks dhe qejf! (Abdulla, Abdulla, Abdullath¹¹

6- Pekini, udhëtimi i së panjohurës dhe bashkudhëtim i çastit

Sa i panjohur e i çuditshëm, aq edhe bashkudhëtar i një periudhe gati të pakuptueshme për jetën kulturore, Pekini zbardh një rrugëtim-devijim. Atje hyn në lojë Makbethi. Libri i fëmijërisë, i pari që ndryshoi shumë gjëra, vjen e hyn në skenë, duke u bërë shpjeguese e zhdukjes së zëvendësit të Maos, mareshalit Lin Biao. Ka lidhje të drejtpërdrejte me Tiranën, por Tiranë shpjegohet nga Kina, atje ku janë ndaluar thuajse të gjitha veprat me të cilët krenohet bota, ku ka stopuar mendimi. Atje veçse Makbethi nuk lexohet, por praktikohet, me aludimet e vrasjes së Lin Biaos, një aludim që përputhet me shumëçka që ndodh në Tiranë.

Me rikthimin e versionit të ndaluar të Shekspirit, dhe vrasjen e Lin Baos në versionin shekspirian, Pekini merr trajtën e një teatri ku luhen gjërat e shkuara. E tashmja vjen ngadalë, por është nga ata të tashme që ka frikë të lexohet. Kështu, e panjohura për Gjergjin, kthehet në lojën teatrale ku realiteti nuk ndodh as pasi mbaron shfaqja. Paralelisht në Tiranë është punëtori që krejt pa dashje ka aksidentuar punëtorin kinez, duke kthyer nga tragjiko-komike gjithë raportin e këmbës dhe fati që sjell ajo këmbë në disa jetë.

“*Koncerti... ishte mësymja ime më e thellë në lindje: në shkretëtirën e Gobit, në kryeqytetin kinez, madje nën nëtokën kineze*”, shprehet Kadare në “Ftesë në Studio”¹² duke konfirmuar edhe vetë “largimin në gjeografi”, i cili ishte në mendjen e tij vetëm nga një udhëtim me një grup shkrimtarësh nga Lidhja e Shkrimtarëve në Pekin.

Sociologjia e fabulave shëtitëse te Kadare

Personazhe që kanë shëtitur nga njëra vepër tek tjetra. Fabula që kanë shtegtuar nga njëra vepër tek tjetra. Cilat janë ata që kanë udhëtuar bashkë me autorin, duke qenë dëshmitarë të rritjes së tij. Miti i Kthimit të Doruntinës me vëllain e vdekur Kostandinin, është fabula më e përsëritur, që nga tregimet më të para e deri kur u botua për herë të parë në një vepër të veçante me titullin “Kush e

¹⁰ I. Kadare, *Rrethimi*, Onufri, Tiranë, 2008, f. 98-99.

¹¹ I. Kadare, *Ura me tri harqe*, “Naim Frashëri”, Tiranë, 1978, f. 45.

¹² Po aty, f. 298.

Solli Doruntinën?”. Nis që në “Muzgun e perëndive të stepës” që të tregohet. Te romani *Hija* kthehet në bashkudhëtaren e madhe të lëvizjeve të personazhit mes Parisit dhe Tiranës, për të ardhur më pas si libër më vete. Por pavarësisht qëndrimit më së shumti në këto tri vepra, “Doruntina” përfshihet edhe në poezi edhe në rrëfenja të tjera. Të romani *Ura me tri harqe* Doruntina vjen sërish si shpjegim për baladat dhe i paraprin bashkimit me baladën tjetër, atë të “murimit”.

Harta e krijuar sociologjike e personazheve, duke krijuar një “glob interesant”, me personalitete të ndryshme. Përveçse ka një gjeografi shtetesh në rrafshin e lëvizjeve, ai ka edhe një lëvizje shpirtërore në këto vende, duke krijuar një gjeografi të dyfishtë - të shteteve dhe traditave. “Hani i dy Robertëve” është “shtëpia gjithë shoqëruese” e udhëtarëve të tij në sagën e vizitorëve që vijnë nga Perandoria Osmane, por edhe te “Kush e Solli Doruntinën”.

Gjirokastrën, qytetin e tij, që kërkon ta largojë nga gjithçka, sidomos nga këndvështrimi i pastër historik, ai e veçon nga çdo gjë tjetër, madje edhe nga natyra. “*Vështroja peizazhin e ndryshuar brenda natës dhe mendoja se si lumi e urrente urën, xhadeja urrente me siguri lumin, përrenjtë urrenin muret, era urrente malin që i priste furinë, dhe të gjitha këto bashkë urrenin qytetin, i cili shtrihej i lagur, gri e mospërfillës, midis kësaj urrejtjeje shkatërrimtare. Unë e doja atë, sepse në këtë luftë ai ishte i vetëm*”¹³.

Ana Krasniqi është ndërkaq gruaja që shfaqet sidomos në tregimet e Tiranës, në rrëfenjat që kanë fokus kryeqytetin. Megjithatë, Ana duket si ku rron edhe në lëkurën e Dianës, Zanës, Silvës.

Mes dy botëve

Vdekja, mungesa dhe flijimi janë tri motive që jo pak herë shëtisin personazhet mes dy botëve. *Prilli i thyer*, *Kush e solli Doruntinën* janë ndoshta motive ku vdekja dhe jeta qëndrojnë fare ngjitur, fytyrë të njëra-tjetrës. Por raporti i një “vdekjeje të duhur” përshkruan disa prej prozave kryesore, ndërkohë që “purgatori” vjen përmes *Nëpunësit të pallatit të ëndrrave*, që i lidh këto dy botë pikërisht me atë që psikologu Gustav Jung e konsideron se “nuk jemi ne që vendosim ta shohim, por që është e jona kur e tregojmë”. Mes dy botëve mbetet edhe Murrash Zenebisha te *Ura me tri harqe*, i cili nuk është mes të gjallëve, por as nuk shkon dot mes të vdekurve, por mbetet pikërisht aty, në urë, që lidh jo dy brigje, por dy botë.

- *Madhështore, - klithi ai mbyturazi. - i gjalli dhe i vdekuri, hipur mbi të njëjtin kalë. Një e vërtetë e përjetshme. Po, po. Te çdo njeri i gjallë ka diçka të vdekur dhe te çdo i vdekur ka diçka të gjallë. Kjo baladë është e hatashme në bukurinë e saj.*¹⁴

Ky udhëtim “në urë Sirati” (Ura që në librat e shenjtë lidh ferrin me parajsën) nis që me *Gjeneralin e Ushtrisë së Vdekur*, ku kujtimi i tyre do të sjellë ngjarjet e mëpasshme të rindërtuara si një mozaik. Te *Kronikë në Gur* është fare afër vdekja dhe mund të ndodhë nga çasti në çast për hiqmosgjë.

¹³ I. Kadare, *Kronikë në gur*, f. 62-63.

¹⁴ I. Kadare, *Ura me tri harqe*.

Kadareja dhe sistemi

Libri Dialog me Alain Bosque

Kadare shpjegon vendimin e tij për të mbrojtur veprën- të fusë në vepër partinë, e sidomos diktatorin, duke e pranuar si taksë që duhet të paguante për vijimin e veprës: “Rrezikun e konformizmit e kuptova kur shkrova e botova romanin “Dasma” më 1967-1968. Ndonëse vepra u botua më pas në disa vende, ndonëse BBC e Londrës i bëri një radiodramatizim (“Dasma dhe fantazma”), unë aty për aty e kuptova se kjo ishte fillimi i vdekjes sime si shkrimtar, ndaj vendosa të mos bëja kurrë asnjë lëshim në letërsi.

Zgjidhja e dytë: braktisja e letërsisë, më dukej gjithashtu vdekje, ndonëse e një lloji tjetër. Kisha në trurin tim një univers të tërë, që priste të dilte. Shqipëria kishte nevojë për atë ciklon. Ishte mëkat ta lija të vdiste aty ku kishte lindur... Poeti tragjik i viteve '30, Migjeni, kishte thënë për veprën e vet: “Unë djepi juaj e ndoshta varri juaj”. Unë s’doja të bëhesha varr i veprës sime.

Mbetej zgjidhja e tretë: taksa. Taksa paguhej nga të gjithë. Në çdo libër ishte e detyrueshme përmendja e partisë komuniste. Por për një liri të madhe edhe taksa duhej të ishte e pazakonshme. Dhe unë kisha nevojë jo për një liri gjysmake.¹⁵ Te Prilli i thyer historia e Gjorgut nis pas 44 vrasjesh - ndryshimi i Shqipërisë fillon pas vitit 1944.

Te Ura me tri harqe, dy kronikanët turq flasin për të ardhmen e Shqipërisë. Është 50 vjet përpara se të lindë Skënderbeu. Sistemi thoshte: Skënderbeu dhe Enveri. Ja si shprehen dy kronikanët:

“Qysh tani koha do të fillojë ta mbrujë udhëheqësin e ardhshëm. Do t’i duhet ndoshta pesëdhjetë vjet për ta nxjerrë, ose pesëqind vjet për ta përsëritur, kjo s’ka rëndësi. Ai do t’i vijë. Do t’i vijë Shqipërisë... Ai që do ta kthejë mbrapsht munxën e tmerrshme që na dërguan të huajt. Ai që do ta kthejë përpara akrepat e orës.¹⁶

Në 30 faqet e fundit të romanit *Kronikë në gur*, jepen dy plaka duke folur “për djalalin e Hoxhatjave që drejton luftën”, për “nipin që vret xhaxhain se i tradhtoi partizanët duke u bërë me ballin” dhe “për vajzën që del partizane”.

(Parashikimi për prijësit e ardhshëm partizanë te *Komisioni i Festës*)

Nuh Efendiu u kthye në “Haxhillëkun e lejlekëve” pothuajse i dërrmuar. Megjithëse nuk pritej që pas kësaj ore të mbërrinin mysafirë të tjerë, ai, për çdo rast, nuk e hiqte xhyben ceremoniale. Kishin mbërritur mjaft të ftuar, megjithatë shumica pritej të vinte të nesërmen, gjatë gjithë paradites. Nuf Efendiu vinte e vente në dhomën e tij, me duart pas shpine. Në sy sepse i vinin vazhdimisht veshjet e mysafirëve. Ato fustanella të bardha dukeshin sikur ishin bërë enkas për të të sjellë mendjen vërdallë. Nuf Efendiu e kishte ditur se Shqipëria, përveç pashallarëve të mëdhenj, ka pasur përherë prijës më të vegjël, madje një mik i kishte thënë para ca kohe, se pikërisht këta të vegjlit e vinin në lëvizje rrebeshin e Shqipërisë, më tepër se vezirët e famshëm. Këta ishin prijës të një lloji të veçantë. Shumica e tyre ishin bërë të tillë vetvetiu, duke fituar autoritet në popull, pas

¹⁵ I. Kadare, *Dialog me Alain Bosque*, Onufri, Tiranë, 2002, botim i katërt, Tiranë, f. 34.

¹⁶ I. Kadare, *Ura me tri harqe*, Naim Frashëri, Tiranë, 1978, f. 122.

ndonjë ngjarje apo pas ndonjë lufte, dhe rrallë qëndronte që pushteti qendror të mos i njihnte ata zyrtarisht. Një pjesë e tyre rridhnin nga familjet e vjetra gjysmëlegjendare të kryezotëve të dikurshëm, rrënjët e së cilave, megjithëse në arkivat osmane quheshin të zhdukura, lëshonin akoma filiza përmes kohërave.¹⁷

Dhënia e figurës së Enverit të *Dimri i vetmisë së madhe* e sidomos të *Koncert në fund të stinës* janë pohuar si shpëtimi i deridikushëm i atyre librave, ndërkohë që shpëtim nga vet ish-diktatori kemi edhe në rastin e “Dosjes H”, e cila kishe përmendjen e diktatorit, që u interesuar vetë për librin.

“Tri Doruntinat”

Lidia moskovite, Doruntina shqiptare dhe Silvana parisienne plotësojnë trekëndëshin e baladës së së famshme të ngritjes nga varri për të mbajtur fjalën e dhënë. E nisur në Moskë si rrëfim, e ardhur në Shqipëri si mbijetesë dhe e transferuar në Paris si pjesë e botës që nuk do ta mundë dot fuqinë për një Doruntinë, “tri Doruntinat” e Kadaresë janë një raport i pastër i së pamundshmes edhe kur e ke pranë. Janë absurdi i krijuar nga një realitet që ka krijuar bjerjen e përditshme të gjithçkaje, duke na kthyer në “Kostadin”, pa mundur ta prekim “Doruntinën në kalin tonë, në shtatin tonë apo duke e ëndërruar”.

Cili është personazhi kryesor?

Pavarësisht se është shkruar për thujtje të gjithë personazhet, është përafëruar herë Skënder Bermema e herë Besian Vorpsi, sërish asgjë nuk i afrohet asaj që rrok përmes penës. Nuk ka asnjë personazh që mund të marrë “shtëpi më vete”. Të gjithë janë të detyruar të jetojnë bashkë me autorin. Është ai që vendos, që u jep jetë, që i mbart në çdo hap. Dhe megjithëse me botë të ndryshme, të gjithë kanë nevojë për t’u kuptuar pasi thua “Kadare”. “Polifonizmi” i personazheve të tij, i shpërndarë në Moskë, Pekin, Stamboll, Tiranë, Paris, Gjirokastrë, nuk është veçse jeta e tij e shpërndarë në këto rrugëtime, duke i dhënë të gjithëve nga pak e askujt të gjithën. Ajo është me këdo në kërkim të vetvetes, por pa e dhënë atë kurrë me të tërën. Frika e identifikimit me një personazh duket se kishte dy rreze për të: dukej sikur fokusonte lexuesit vetëm tek një libër dhe bëhej i identifikueshëm nga sistemi. Madje, ishte kjo e fundit që ka dominuar tërheqjen e plotësimit të penelatave, të cilat herë shfaqen më shumë te Skënderi, e herë te Besiani. Megjithatë, për nga natyra e njohjes së femrave dhe jeta në kryeqytet, Skënder Bermema bart më shumë nga ajo çfarë Kadare ka lënë shënime në autobiografitë apo librat ku ai flet për vetveten. Vetëm tashmë vonë, kur boton *Qyteti pa reklama*, arrin të qartësojë disa penelata përmes Gjoni, duke iu afruar vetvetes, por atij të largët.

Në *Qytetin pa reklama*, Gjoni, i cili fill pas mbarimit të universitetit emërohet në qytetin e Gjirokastrës, nuk ishte gjë tjetër veçse një dyzim i vetë Is, por një dyzim negativ, një alter ego e keq.¹⁸ Pas Gjirokastrës, Kadare vendos të ndërtojë penelatat e tij me kineastin. Madje i bashkëshoqëron mikun e tij të shkollës në

¹⁷ Triptiku *Ura me tri harqe*, intermexo Komisioni i Festës, Naim Frashëri, Tiranë, 1978, f. 334.

¹⁸ H. Kadare, *Kohë e pamjaftueshme*, Onufri, Tiranë, 2011, f. 129.

Karuseli sociologjik i personazheve te vepra e Ismail Kadaresë

Moskë, si për të plotësuar tri kohë- atë të fëmijërisë, të studimeve (që përshkruhet te *Muzgu i perëndive të stepës*) dhe të Tiranë-Parisit.

Përfundime

Besojmë se kemi dhënë vetëm disa piketa të botës kadareane përmes konceptit kohë-hapësirë, me disa pika qendëruese - një varg qytetesh a më mirë kryeqytetesh estetikë, në çdonjërin prej të cilëve merr jetë, gjallon e pasqyrohet njëra faqe e kaleidoskopit të madh të botës, dhe brenda të cilëve si në dhomëza të veçanta vërtiten e ndërthuren jetët e personazheve në karuselin e madh të fatit njerëzor. Duke përshkruar këtë karusel sociologjik, u përpoqëm të sjellim përpara lexuesit disa tipare të rëndësishme krijuese, që zbërthejnë laboratorin krijues, që në çastin e njohjes ofrojnë një shumësi leximesh.

Kadare thuajse e ka mbyllur korpusin e veprave të tij, por korrespondenca e tij me kohën e shkrimit dhe kohën e leximeve do të vijojë të jetë një betejë, ku rrugëtimi që ka ndjekur krijimtaria do të ketë pjesën e vet të tërheqjes, për të shkuar sa më afër shumëllojshmërive të leximeve, pa tentuar kurrë që të zëvendësojë shijen e leximit të drejtpërdrejtë dhe të “shkujdesur” nga raportet akademike.

Mbështetja te fëmijëria, te disa qytete që kanë qenë edhe vitet ku ai ka kaluar momentet kyçe të jetës së tij, gërshetimi i dyfishtë mes baladave dhe realitetit, që nuk janë thjesht një lojë mes trillit dhe mungesës së tij, si dhe marrëdhënia e tij me sistemin, ardhur përmes interpretimeve të drejtpërdrejta, formësojnë një raport të vetë Kadaresë me letërsinë e tij, duke na dhënë shënime leximesh që mund të na për afrojnë me qëllimet e këtyre leximeve, qofshin këto thjesht letrare apo jashtëletrare.

